



ZERO TË PANUMËRTA PARA NJËSH-it

ALI SHERIATI

Intelektualët muslimanë të cilët janë të vetëdijshtëm për përgjegjësinë e tyre, duhet ta ngrenë veten në artin e të folurit të brendshëm:

Intelektualë të botës, vëllezër muslimanë, bashkësi të shoqërive qytetare, gra, fshatarë, fëmijë tanë.

Pra ky është një thellim ku vendoset një relacion mendor sipas botëkuptimit fëmijëror; ky është një thellim ku sipas botëkuptimit të të mëdhenjve, të cilët dinë të mbajnë në dorë penën, përcillet ky mendim dhe jepen kahe për fillimin e kësaj rruge.

RUMI–Tetovë

1994

Me emrin e All-llhut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

FËMIJËT TANË KUPTOJNË

Kur personi është i vobektë edhe të mirat nuk i duken, ndërsa ata që janë të fuqishëm, ata që kanë ar(flori) “të këqijat” e tyre duken si “art”, “fjalët e pakuptimta të tyre” dëgjohen si “fjalë me rëndësi”, ndërhyrjet e tyre të palogjikshme dhe të bezdisura kuptohen si filozofi, shkencë, fe, mahitë e ftohta dhe të mërzitshme të tyre” dëgjohen dhe në to qeshtet pa masë.

Edhe shoqëritë janë të tilla

Kur ne muslimanët kishim pasuri dhe ishim të fuqishëm, profesorët e universiteteve të Spanjës e Italisë si dhe filozofët dhe shkencëtarët evropianë në ligjëratat e tyre me dëshirë që t'u përngjasojnë Ibn Sinasë, Raziut dhe Gazaliut i vishnin xhubbet dhe pelerinat e dijetarëve tanë fetarë.

Tash, profesorët e unviersiteteve tona rrobat të cilat i veshin në ceremonialet e ndryshme i marrin prej Perëndimit. Ata mundohen t'i imitojnë Kantin, Dekartin e me këtë marrin pamjen e profesorëve të universiteteve franceze, angleze, italiane e spanjolle.

Zejtaret e krishterë, kur dëshironin t'ua mbyllin sytë blerësve në tregjet e Evropës mbi prodhimet e tyre shtypnin shenjën “All-llah”. Pra kjo është vepër e Belhit, Buharës, Tisit, Rejit, Bagdadit, Damaskut, Egjiptit, Stambollit, Granadës, Kordovës, Andaluzisë, këta bile edhe mbi kryqat e venin këtë shenjë.

Gjatë kryqëzatave ata bënë gjenocid mbi ne, ndërsa ne e masakronim njëri-tjetrin. Krishterët dhe hebrenjtë u bashkuan, kurse muslimanët u ndanë në qindra grupe. Suniti masakroi shiitin, shiiti masakroi sunitin, turku masakroi iranianin, iranianin masakroi arabin, arabi masakroi berberin, berberi tatarin e kështu me radhë. Në të njëjtën kohë në mes tyre lindën mosmarrëveshjet, armiqësitë, mendimet e prishuara, luftërat... të bazuara në nocionet si: i lartë, krenar, kokulur, shejh, sufi, i prapambetur, përparimtar... etj.

Vëndo para vetes hartën e botës. Tërhiqe një vijë të drejtë prej Gjirit Persik drejt Spanjës, prej aty tërhiq një tjetër drejt Kinës, pra ky trekëndësh ishte “Atdheu Islam”: një shoqëri, një besim, një libër.

Kurse tash?

Muslimanët e një mez'hebi, një gjuhe, një vendi, të tubuar në një xhami falin namazin në shtatë mënyra.

Filluan luftërat e shtatëdhjetë e dy shoqërive në mes vëllezërve. Të gjitha shoqëritë u larguan prej Islamit, u kthyen kundër eshtrave të kalburat, kundër vendbanimeve të lashta, kundër legjendave të vdekura,...

E harruan “Zotin” e në vend të tij vunë “Tokën”.

Kokat tona ua bashkangjiten lojërave të dheut, lojërave të gjakut, ndarjes në grupe, ndarjes në shoqëri, luftërave të pakuptimta e mendimeve të pabaza.

Na vunë në gjumë me ninullat e tyre; edhe Perëndimi si mongolët “Erdhën, dogjën, plaçkitën...”

Por, nuk u larguan

Kurse ne, ose e kishim kokën e lidhur në vete e nuk deshtëm ta shohim këtë, ose e kishim sulmuar njëri-tjetrin kështu që nuk e pamë këtë.

Krejtësisht ishim kthyer në periudhën e injorancës, kishim rënë pas varreve të lashta, nuk ekzistonim, prandaj nuk e pamë.

Ata u zgjuan, e ne fjetëm. Krishterët e hebrenjtë u bashkuan e ne qindra grupe u bëmë.

Ata u pasuruan e u forcuan, kurse ne u varfëruam dhe u dobësuan.

Kurse gjendja jonë;

Një grup yni i vazhdonte mosmarrëveshjet e vjetra dhe nuk shihet se ç'bëhej në fytyrë të tokës.

Një grup tjetër i cili nuk dinte se në dorë të kujt është bota, është ulur dhe si majmun vështron zotërinjtë e vet dhe i imiton në çdo pikëpamje.

Sipas tyre vetëm të Perëndimit janë njerëz, vetëm ata meritojnë nderim e respekt. Pse? Perëndimi ka pasuri, ka fuqi.

Ne jemi bërë të varfër, edhe të mirat tona janë zhvlerësuar, të këqijat e atyre që kanë para e pasuri janë shndërruar në art.

Ata dëshirojnë të na bëjnë të gjithëve majmunë si: profesorët tanë, poetët tanë, të parët tanë, artistët tanë, filozofët, gratë, burrat, jetën, qytetet, familjet, fëmijët tanë...

Ata frikohen vetëm prej një gjëje, që ne të mos i "imitojmë".

Si mundet që ata të mos mundemi t'i imitojmë? Kjo është e mundur derisa "ta kuptojmë" vetveten.

Ata, frikohen vetëm që ne "të mos i kuptojmë". Ata nuk frikohen prej trupit tënd pa marrë parasysh se je i fuqishëm. Nuk mund të jesh më i madh se lopa që të të mjelin, nuk mund të jesh më i fuqishëm se gomari të të ngarkojnë, nuk mundesh të jeshë më i shpejtë se kali që të të shalojnë.

Ata frikohen prej "të menduarit" tënd.

Ata mund të mendojnë që përparimtarët të mendojnë gjëra të kota, edhe fëmijët duhet të edukohen në këtë mënyrë, për ate që do ta mësojnë assesit të mos mendojnë, të bëhen fëmijë të pastër, të shëndoshë, të lumtur, të buzëqeshur, të mosefusin kokën kudo...

Na falni!

Ç'të bëjnë? Duhet t'i hyjnë një pune të tillë ku trurin prej kokës ta transferojnë tek sytë. Si? Nëpërmjet një metode mjaft të re amerikane: Perceptimit.

Kjo do të thotë vetëm sytë të të punojnë. Kjo do të thotë vetëm veshët të të punojnë. A thua vallë pse? Për të kuptuar atë që fshehin, për të kuptuar punët që ata i bëjnë ndër mbulesa dhe pa nxjerrë zë.

E gjithë ajo që ata e sjellin dhe e marrin bëhet "fshehtas dhe pa zë".

Fëmijët tanë e shohin si dhe e dëgjojnë zërin e butë të këmbëve të maces së zezë vjedhacake e cila ngjitet nëpër mur dhe hyn nëpër dritare. Pra fëmijët tanë "kuptojnë". A nuk e shihni zjarrin e shkrepësës e cila gjendet në sytë e këtyre fëmijëve të mprehtë e këmbëzbathur të shkretëtirës?

Po, fëmijët tanë çdo gjë kuptojnë.

Dynjanë, ahiretin, çdo gjë në dynja, lëvizjen e çdo gjëje, të pakuptimtën, të kuptuarën, ahiretin, të qenurit për vete, të qenurit për shoqërinë, të qenurit për Zot bile edhe shehadetin (dëshminë)...

"Të bërit Një,

bile edhe zerot

e panumërta

para

Një-shit.

Ali Sheriati

Një paska
Një s'paska
Përveç “All-llahut”
Asgjë nuk paska
Askush nuk paska
All-llahu i vetëm paska qenë
All-llahu dashës paska qenë
All-llahu paska vështruar
All-llahu të bukurën e paska dashtë
All-llahu të mirën e paska dashtë
All-llahu të maturën e paska dashtë
All-llahu heshtjen nuk e paska dashtë
All-llahu pasivitetin nuk e paska dashtë
All-llahu “asgjënë” nuk e paska dashtë,
All-llahu “të mosqenurit” nuk e paska dashtë,
All-llahu “krijues” paska qenë,
A mundej “të mos krijonte”
Menjëherë krijoi retë,
Ia la gjithësisë “të mosqenurit”,
retë e krijuara prej “thërrmijave”,
Çdo thërrmi:
Një univers i vogël; emri i tij: Atom
Mu në mes një diell,
Rreth tij, një yll, yje, fluturojnë e rrotullohen
(Një Qabe, rreth saj ithtarët në rrotullim).

Retë lëvizjes ia filluan,
I fuqishëm, i ndritshëm, në zierje, në lumturi,
Si tym,
Si pluhur,
Si rreth,
Si enë e varur e zjarrit:

Një atom i madh, emri i tij: Univers
Mu në mes një diell,
Rreth tij, një yll, yje, fluturojnë, rrotullohen.
(Rreth një Qabeje, ithtarët në rrotullim! Prej Gurit të zi drejt Gurit të zi).

Jeta u zhvillua,
Bimët:
Prej algave të vogla deri në drurët gjigantë,
Shtazët:
Prej mikrobeve deri tek mamutët,
Në fund njeriu:
Të këqijtë e të mirët,
Të mirët, më të mirë prej të gjitha të mirave,
Të këqijtë më të këqij prej të gjitha të këqijave:
Të këqijtë si Shejtani,
Të mirët si All-llahu

Jeta, “një thërmijë me shpirt” një “bërthamë”,
Një bërthamë bime:
Në tokë gjelbërohet, kalbet, zhvillohet, bëhet fidan,
pipëton, çel degën e gjethin, jep lule e fryt, vjetërohet,
thahet, vdes, bëhet dhe,
Prej saj përsëri mbetet bërthama, si në ditën e parë,
Një vezë e shtazës:
pjellë, foshnjë, i ri, i rritur, i pjekur, i vjetër,
vdekje,
Jeta zhvillohet:
Një bërthamë bime, një vezë shtaze,
Prej mëngjesit të lindjes deri në mbrëmjen e vdekjes,
lëvizje gjatë tërë jetës, zierje, orvatje, brenda
lëvizjes,
Çdo moment në një vend tjetër,

Çdo vend në një gjendje tjetër,
Në çdo kohë në çdo vend, në kërkimin e shijes, rreth
domosdoshmërisë,
prej lindjes deri në vdekje.
Edhe jeta rrotullohet,
Mu në mes një diell,
- domosdoshmëri -
Rreth tij një i gjallë, të gjallët fluturojnë, rrotullohen
Prej të mosqenurit, kah mosqenia,
(Një Qabe rreth saj, ithtarët në rrotullim!
Prej Gurit të zi drejt Gurit të zi).

Një paska, një s'paska,
Përveç All-llahut
Asgjë nuk paska
Askush nuk paska,
Dynjaja u krijua,
Thërmijat, universet, gjallesat...
tokat, qiejt, yjet, diejt, lindjet, perëndimet,
Bimët, shtazët, konkretet, abstraktet,
Çdonjëri në lëvizje, në orvatje,
brenda një sistemi pasiv
në një ndryshim të vazhduar,
Jeta me vdekjen kishte mbaruar, vdekja pjellë e jetës,
Dita me natën kishte mbaruar, nata pjellë e ditës,
Çdo gjë në lëvizje çdo gjë në rrotullim:
Mu në mes një diell,
Rreth tij, një yll, yjet, në rrotullim,

(mu në mes një Qabe, rreth saj ithtarët, në rrotullim,
Prej Gurit të zi drejt Gurit të zi).

Një paska

Një s'paska

- Përveç All-llahut

Asgjë nuk paska,

Askush nuk paska,

Krijimtaria mori fund, universi u bë,

tokat e qiejt, yjet e diejt, lindjet e perëndimet,

Gjallesat e trupat e vdekur, bimët e shtazët,

Thërrmijat e universet,

Çdo gjë brenda një sistemi pasiv, gjithnjë në ndryshim

e sipër, në lëvizje të përgjithshme.

në lëvizje të pafund, gjithnjë në kërkim, në kërkim të

një gjëje,

rreth e rrotull një gjëje rrotullohen:

Mu në mes një diell,

Rreth tij, një yll, yjet në rrotullim,

(Mu në mes një Qabe, rreth saj ithtarët në rrotullim,

Prej Gurit të zi drejt Gurit të zi).

Pse vallë të gjitha qeniet në univers kanë formën e rrethit.

Toka, ylli, dielli,

Elektroni, protoni,

Çdo molekulë, çdo, atom,

Çdo një thërrmijë:

- Gurthemeli i këtij universi,

Një univers:

- Një qytet, një fshat prej atdheut të pafund të qenësisë -

A thua pse vallë të gjitha lëvizjet në univers janë në

rreth?

Toka, ylli, dielli,
Elektroni, protoni,
Çdo molekulë, çdo atom,
Çdo një thërrmijë:
Gurthemeli i këtij universi,
Një univers:
- Një qytet, një fshat, prej atdheut të pafund të qenësisë -
Çdo një gjallesë:
Qoftë bimë apo shtazë,
është në rrotullim e sipër,
të gjitha qeniet në univers janë në rrotullim e sipër:
Uji, dheu,
nata, dita,
mëngjesi, mbrëmja,
Çdo sekondë, çdo minutë, çdo orë,
çdo javë, çdo muaj, çdo stinë, :
Pranvera, vera,
Vjeshta, dimri,
Çdo vit.
Një paska
Një s'paska
Përveç All-llahut, asgjë nuk paska,
Askush nuk paska,
Tokat paskan qenë,
Qiejt paskan qenë,
Yjet, diejt,
Lindjet, Perëndimet,
Gjithësia e Universit pa kënd e fund,
Në këtë mjedis,
Mu në mes një diell,
Rreth tij një yll, yjet në fluturim, rrotullim:
Një “univers” në përgjithësi,

Në atë mjedis edhe një univers tjetër,
edhe një tjetër,
Dy, tri, dhjetë copa, njëqind copa, një mijë copa,
një milion, një miliard...
Sa miliardë, miliardë, askush nuk e di se është miliard!

Mbi një gjeth shkruaje numrin “Një”,
Sa të kesh fuqi, para një-shit ven zero,
Kur të kryhet njëra anë kalo në anën tjetër,
Kur të kryhet gjethi blej një gjeth tjetër,
Kur të soset ngjyra e pemës, mbushe me ngjyrë,
Kur të kryhet ngjyra blej tjetër ngjyrë,
Kur të të lodhet dora,
Lute shokun që t’i shkruajë zerot,
Kur të lodhet dora e tij, vazhdo përsëri ti,
Kur ti do të hash bukë, zerot le t’i shkruajë ai,
Kur ti do t’i shkruash zerot, ai le të hajë bukë,
Gjatë natës flini me radhë,
Ti shkruaj zerot, ai le të flejë,
Kur të zgjohet, ti flej, ai le t’i shkruajë zerot,
Kur të plakeni, thuajuni djemve tuaj që të vazhdojnë
këtë punë,
Nga fundi i jetës,
Kur tepër do të plakeni,
Një moment largoni dorën prej kësaj pune:
Ditën e parë ishit vetëm dy fëmijë,
Dinit të shkruani vetëm zero,
Kurse tash jeni dy pleq të shtrirë,
Mundeni vetëm të numëroni zerot,
Përsëri fëmijë jeni bërë,
Jeni bërë si në ditën e parë,
Në ato ditë të rriturit ndjenin dhembje e dashuri

ndaj juve,
Ju mbronin, aty-këtu talleshin me juve,
Tash të vegjël,
pasi jeni edhe më fëmijë se atëherë,
Pasi tash jeni fëmijë në vite,
Fëmijë me mjekër e mustaqe,
Keni marrë rrugë tetëdhjetë vjet, nëntëdhjetë vjet,
njëqind vjet, keni punuar,
Vitet e jetës, vitet, prej viteve i keni kaluar,
Më në fund përsëri jeni kthyer në fillim,
Përsëri jeni bërë fëmijë,
Dhe ishit ushqim, u bëtë,
Një kafshatë në gojën e babës,
Një kafshatë në gojën e nënës,
Një thërrmijë në zemrën e nënës,
Një thërrmijë në belin e babës...
Nëna e baba u martuan,
Ajo thërrmijë e kjo thërrmijë u bashkuan,
Ai “një” u bëre “Ti”,
Në barkun e nënës,
Si një vezë në barkun e pulës,
Me nxehtësinë e trupit të nënës, me gjakun e saj,
Ti gjete jeten, ti u rrite,
Si një vezë përfund pendlave të pulës,
Nëntë muaj kaluan, nëntë ditë kaluan, nëntë orë kaluan,
Nënës i filluan dhembjet:
“Vezën e theve”,
“Menjëherë u hodhe jashtë”,
Hyre në brendësinë e djepit,
sytë s'të shihnin,
veshët s'të dëgjonin,
këmbët s'të ecnin,

duart s'të mbanin,
Truri s'të punonte,
Asgjë nuk kuptoje,
Askend nuk e njihje,
Ishe i hedhur në brendësinë e djepit,
Dije vetëm tri folje:
1. - Të thithësh gjirin, 2. - të bësh nevojën në vete,
3. Të qash!
Njëqind vjet kaluan,
Sytë s'të shohin, veshët s'të dëgjojnë, këmbët
s'të ecin, duart s'të mbajnë, truri më s'të punon,
Asgjë nuk kupton, askend nuk e njeh,
Ke ra në shtrat,
Di vetëm tri folje:
1. - ..., 2. - ..., 3. - ...,
Pastaj vdes,
Të hedhin në barkun e tokës,
edhe një herë bëhesh dhe,
prej teje nuk mbetet asgjë,
“Ti” mbetesh,
biri i njeriut kthehet:
Si toka, si lavra, si pranvera, si çdo gjallesë,:
Ujit, trëndafili, toka, ylli, dielli, universet,
galaktika, të qenurit.
Asgjë ishe, dhe ishe u ktheve, asgjë u bëre,
dhe u bëre,
Prej teje mbeti vetëm një gjë:
Mbetën vetëm veprat e bëra,
Mbetet çdo vepër që ke bërë,
... Nëse bën një vepër mbetesh gjallë,
Tash ulu, o fëmijë në moshë,
Sa u bë numri i universeve, yjeve?

Para “Një-shit” një milion zero apo?
Një milion zero? Ose një miliard? Ose një kilometër?
Ose njëqind kilometra?
Ose njëqind fersahë (12000 hapa)?
Të gjitha gjallesat shumëzoi me të gjitha gjallesat,
Të gjitha rezultatet shumëzoi me të gjitha rezultatet,
shumëzo e shumëzo.
Nëse kryhet njëra anë kalo në anën tjetër,
Nëse kryhet gjethi blej një tjetër,
Kur të soset ngjyra...
Kur të lodhet dora...
Gjumi..., haja..., shoku..., vazhdo..., fëmijët...,
Numri i yjeve, universeve, gjallesave, në ekzistencë sa u bë?
“një”,
Para një-shit zerot,
Një mijë zero?
Një milion zero? Një miliard?
Njëqind kilometra? Njëqind fersahë?
Deri ku mbërrini rendi i zerove para Një-shit?
Përtej qytetit?
Përtej atij malit?
Përtej detit?
Deri në shkretëtirë?
Deri në horizont?
Përtej Tokës?
Deri në fund të botës?
Jo, jo deri në pafund, në çdo vend,
Sa mund të numërosh,
deri në zerot që kisha mundësi t'i vesh para një-shit,

Numri i bimëve,
Shpezëve, zvarranikëve, barngrënësve,

njerëzve, meleqve,
tokave, qiejve,
yjeve, diejve, universeve,
konkreteve, abstrakteve,
të poshtërve, të ndershmeve,
të shëmtuarve, të bukurve,
numri i së mirës dhe së keqes
çdo gjë që ekziston
çdo gjë që është brenda këtij rruzulli tokësor,
çdo gjë që ka emrin qenie,
i tërë universi, të gjitha qeniet, e gjithë është kjo,
Domethënia e dynjasë është kjo,
Qoftë e hapur, qoftë e fshehtë,
Numri i të gjitha qenieve brenda universit,
Qoftë në tokë, qoftë në qiell
Qoftë i vdekur, qoftë bimë,
Numri i shtazëve, njerëzve,
numri i yjeve, diejve, universeve,
Numri i tërë ekzistencës është ky:
“Një”
Para tij
zero
të panumërta,

Shiko:

Vetëm “një-shi” është numër

Shiko:

Vetëm “Një numër” është.

Çdo qenie përveç “Një-shit”,

- qoftë dhjetë, qoftë njëqind, një mijë, milion, miliard, panumër qoftë-

Numër nuk ka, asgjë s'ka,

Të qenurit vetëm të mos qenur,

të mosqenurit vetëm të qenur,
“Zerot”! Kjo do të thotë: “Të zbrazëta” janë, “Zero” janë,
“Asgjë” janë,
“Të zbrazët” janë,
“Të pakuptimta” janë,
Bile edhe “Një” numër i zbrazët e i thatë nuk janë.
“Nuk” janë!

Vetëm “Një” numër është prandaj
Vetëm “Një numër” është prandaj,
Vetëm nëse kjo “zero” kalon para “Një-shit”???!
Zerot kur të kalojnë para një-shit,
“Një-shin” e bëjnë qindra, miliona, miliarda,
Kurse qindrat, milionat, miliardat,
Vetëm “Një” janë,
Qindrat “Një”, milionat “Një”, miliardat “Një”...
Vetëm “Një” numër është prandaj,
Dy, tre, katër, pesë, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë,
Domethënë:

Dy njësha, tre njësha, katër njësha, pesë njësha, gjashtë
njëshja, shtatë njësha, tetë njësha, nëntë njësha,
njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë, trembëdhjetë, katërmëdhjetë,
pesëmbëdhjetë, gjashtëmbëdhjetë, shtatëmbëdhjetë,
tetëmbëdhjetë, nëntëmbëdhjetë, njëzet,
Tridhjetë, katërdhjetë, pesëdhjetë, gjashtëdhjetë,
shtatëdhjetë, tetëdhjetë, nëntëdhjetë, njëqind...,
Dyqind, treqind, katërqind, pesëqind, gjashtëqind,
shtatëqind, tetëqind, nëntëqind,
Një mijë, milion, trilionë, katërlionë... të gjitha.

Vetëm
“Një” është, tjetra që mbetet është zero!

Në matematikë:

Vetëm “Një” është numër,

Çdo gjë që mbetet,
është zero.
Të gjitha janë zero,
Asgjë janë,
Zbrazët janë,
Në tërësi janë zbrazët,
Zero-ja është një rreth i zbrazët,
rrotullohet,
Fundi takohet me fillimin...,
Asgjë!
Kështu pra!
Vetëm,
Një është, e para tij “Zero të panumërta”
Zero-ja: Zbrazët, në tërësi zbrazët asgjë!
Kur të dëshiroj të mbetet vetë,
Vetëm me zero kur të dëshiroj të mbetet,
Shpëton prej zbrazëtisë, prej vetmisë
Bëhet bashkë me Një-shin!

Ti fëmijë i vogël,
Fëmijë nëntë a dhjetëvjeçar!
Asgjë ishe, dhe u bëre, ushqim u bëre,
Pas tetëdhjetë, nëntëdhjetë viteve, një fëmijë
në moshë do të bëhesh,
Asgjë do të bëhesh, dhe do të bëhesh,
Rrotullohesh,
Në rreth,
Pa fortifikatë, pa domethënie, i zbrazët:
Prej fundit përsëri kthehesh në fillim,
Si zero-ja,
Kur të jetosh për veten,
Kur të dëshirosh të jesh vetëm për “veten”,

Kur të dëshirosh të jesh vetëm me zeron
Si një vijë e lakuar e jetës,
rrotullohet rreth teje
Si zero,
përsëri prej fundit kthehesh në krye!
Mbetesh, qelbesh,
Si liqen, si basen,
Mbyllesh, si rreth,
Si “zero”!
Kurse nëse kalon para “Një-shit”?!...
Nëse dëshiron të bëhesh vetëm për “Një-shin”,
Shpëton prej zbrazëtisë, prej vetmisë,
Bëhesh bashkë me “një-shin”?!...
Duhet të jetosh për të tjerët,
Jeta, zhvillohet si një vijë horizontale,
Si rrugë,
si lumë,
Duke u larguar prej “vetes”,
Prej fundit, drejtohesh drejt ndërtimtarisë si rrugë,
Prej fundit, derdhesh në det si lumë,
Kurse nëse para “Një-shit” kalon,
Vetëm për “Një-shin”,
Duhet të vdesësh për të tjerët,
Jeta të ngrihet si një vijë vertikale,
Si valë
Si tufan
Si një maje e lartë krenare,
brenda majeve,
I lirë si druri i lisit
i drejtuar drejt diellit,
Në mesin e algave i ngritur drejt qiellit,
Si një “person i lartë”, “një dëshmor”, “një imam”,

“Mburojë”, në mesin e ujqëve të egër, në mesin e
dhelprave, në mesin e minjve, në mesin e mizave,
Ngriesh, e mbetesh,
Në mesin e zerove
Si “Një”
Po
Vetëm “Një” është numër,
Vetëm “Një numër” është,
Numri i yjeve, universeve,
tokave, qiejve,
Numri i të gjitha qenieve në univers
“Një”,
- para tij zero të panumërta -
“Një” ka
“Një” nuk ka,
Përveç All-llahut
Asgjë nuk ka,
Askush nuk ka.